



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

NR. AKTI 1297

NR. VENDIMI 2091



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

NR.AKTI		1297
NR. I VENDIMIT 2091		
DATE	13.02.2017	REGJ
DATA 12.07.2017		

VENDIM

“NE EMER TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga gjyqtarët:

TEREZA LANI (MERKAJ) - Kryesuese,
ALTIN ABDIU - Anëtar,
ARDIAN KALIA - Anëtar,

Asistuar nga sekretarja **Elisabeta Tusha**, sot në Tiranë më datë **12.07.2017**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, me pjesëmarrjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë të përfaqësuar nga Prokurori *** çështjen penale në ngarkim të:

TË PANDEHURIT: ***, i biri i *** dhe i ***, i datëlindjes ***, lindur në *** dhe banues në ***, me arsim tetëvjeçar, i martuar, me dy fëmijë, i proceduar fillimisht me masën e sigurimit personal “Arrest në burg” dhe më tej me atë “Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”, i pranishëm në gjykim, i padënuar më parë, i mbrojtur në gjykim nga Av. ***, me Nr.Licence ***, anëtar i Dhomës së Avokatisë ***, i zgjedhur prej tij.

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprave penale të “*Shkeljes se të drejtave të pronësisë industriale, të kryer në bashkëpunim*”, të parashikuar nga neni 149/a/2 i K.Penal dhe “*Prodhimit të kundërligjshëm të artikujve dhe mallrave industriale dhe ushqimorë të kryer në bashkëpunim*”, të parashikuar nga neni 288/a/2 i K.Penal.

Në përfundim të gjykimit të zhvilluar në prani të prokurorit të çështjes, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, u kërkua prej tyre:

Prokurori:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit *** për kryerjen e veprës penale “*Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industriale dhe ushqimorë*”, kryer në bashkëpunim, më shumë se një herë, të parashikuar nga neni 288/a-2 i K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 3 (tre) vjet burgim.
2. Deklarimin fajtor të të pandehurit *** për kryerjen e veprës penale “*Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale*”, kryer në bashkëpunim, më shumë se një herë, të parashikuar nga neni 149/a-2 i K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 1(një) vit burgim.
3. Në bazë të nenit 55 K.Penal dënimit e të pandehurit *** me 3 (tre) vjet burgim.
4. Aplikimin e nenit 406 të K.Pr.Penale.
5. Në bazë të neneve 59 dhe 60 të K.Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit për një periudhë kohe 24 muaj, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale po aq të rëndë apo më të rëndë dhe të mos shoqërohet me persona të dënuar.
6. Shpenzimet procedurale në fazën e hetimit dhe ato në fazën e gjyqimit t'i ngarkohen të pandehurit.

– Mbrojtësi i të pandehurit *:**

- Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit *** për kryerjen e veprës penale “*Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industriale dhe ushqimorë*”, të parashikuar nga neni 288/a/2 i K.Penal, pasi nuk provohet që i pandehuri e ka kryer veprën penale.
- Pushimin e gjyqimit për veprën penale “*Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale*”, të parashikuar nga neni 149 K.Penal për shkak të amnistisë të parashikuar nga Ligji Nr.141/2016.

I pandehuri *:**

Dakort me avokatin.

Gjykata, pasi dëgjoi parashtrimet e palëve në seancë gjyqësore dhe si shqyrtoi në tërësi provat e marra në gjykim në lidhje me çështjen,

VËREN

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka sjellë për gjykim çështjen penale në ngarkim të të pandehurit *** i akuzuar për kryerjen e veprave penale të “Shkeljes së të drejtave të pronësisë industriale”, të parashikuar nga neni 149/a/2 i K.Penal dhe “Prodhimit të kundërligjshëm të artikujve dhe mallrave industriale dhe ushqimorë”, të parashikuar nga neni 288/a/2 i K.Penal.

Përpara çeljes së shqyrtimit gjyqësor të çështjes, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij kërkuar që Gjykata të procedojë me gjykim të shkurtuar të çështjes, në bazë të nenit 403/1 të K.Penal, duke pranuar që gjykimi të zhvillohet në gjendjen që janë aktet në Fashikullin e Prokurorisë të sjellë për gjykim.

Prokurori i çështjes u shpreh dakort me këtë kërkesë të mbrojtjes për gjykim të shkurtuar, ndaj dhe Gjykata bazuar në nenin 404 të K.Pr.Penale, pasi u njoh me aktet hetimore, vendosi të procedojë me gjykim të shkurtuar, duke çmuar për zgjidhjen e çështjes penale në gjendjen që janë paraqitur aktet nga Organi i Prokurorisë.

Rrethanat e faktit lidhur me këtë procedim kanë rezultuar si më poshtë:

Mbi bazën e materialeve referuese të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, më datë 24.06.2016 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka rregjistruar procedimin penal Nr. ***

fillimisht për veprat penale të parashikuara nga nenet 149/a, 180, 190 e 288/a të K.Penal në ngarkim të shtetasve ***, ***, ***.

Konkretisht nga hetimi ka rezultuar se sipas një informacioni që dispononin punonjësit e Policisë se në një banesë në *** të Qytetit të Tiranës, prodhoheshin në mënyrë të kundërligjshme artikuj industrialë, janë kryer vëzhgimet përkatëse dhe ka rezultuar se rreth orës 7:00 të datës 24.06.2016 nga banesa ka dalë një automjet i markës “****” me targë ***. Sapo ky automjet ka dalë është ndaluar dhe kontrolluar nga shërbimet e Policisë. Pas kontrollit janë gjetur brenda tij një sasi prej 128 copë shampo të llojeve të ndryshme si ***, **, etj. Ky automjet drejtohej nga shtetasi ***.

Më tej, nga aktet evidentohet se punonjësit e Policisë pas ndalimit të automjetit të mësipërm, kanë ushtruar kontroll pikërisht në banesën nga e cila ka dalë automjeti, dhe ka rezultuar që kjo banesë është në pronësi të shtetases ***, por që sipas deklarimeve të saj të dhëna në hetim ajo prej disa kohësh katin e parë të banesës së saj ia kishte dhënë me qera prej dy vjetesh shtetasit *** dhe bashkëjetueses së tij, shtetases ***, duke mos qenë në dijeni të aktivitetit të kryer brenda saj.

Nga kontrolli i ushtruar në banesë ka rezultuar se në katin e parë të saj janë gjetur artikuj industrialë të prodhuar në atë ambient të tilla si: shampo të mbushura dhe të ambalazuara, detergjentë të markave ACE, Mastro Lindo, Fairy, Euromega, të mbushur, si edhe një numër i konsiderueshëm etiketash të ndryshme, stampa, shirita ambalazhi, fuçi me lëngje në ngjyra të ndryshme, tapa shishesh etj, të cilat janë sekuestruar.

Në banesën e mësipërme, përveç shtetasit *** është gjetur edhe shtetësja ***, e cila në hetim ka deklaruar se këtë aktivitet e kryente bashkëjetuesi i saj *** dhe ajo kishte dijeni se ky aktivitet ishte i rregullt.

Në vijim të veprimeve hetimore është kërkuar informacion nga Drejtoria e tatimeve dhe Q.K.R-ja nga ku ka rezultuar se shtetasit ***, *** e *** nuk figurojnë si subjekte tregtare të licencuar apo të punësuar në ndonjë subjekt të tillë.

Gjithashtu nga organi procedues është marrë vendimi për kryerjen e një ekspertimi kimik dhe i është dërguar Institutit të Policisë Shkencore Tiranë për të përcaktuar nëse elementët kimikë për shampot e sekuestruara janë në përputhje apo jo me ato të përshkruara në ambalazhin e tyre. Nga përgjigja e marrë nga ky Institut me Shkresën Nr. *** datë 08/11/2016 ka rezultuar se në atë laborator nuk bëhen ekzaminime për lëndët kimike, detergjent.

I pyetur në lidhje me faktet objekt procedimi në fazën e hetimit bashkëipandehuri, shtetasi *** ka deklaruar se, e pranon faktin penal dhe autorësinë në kryerjen e kësaj veprimtarie dhe është shprehur se një veprimtari të tillë e ushtronte në mënyrë të paligjshme dhe me qëllim fitimi duke shpërndarë për shitje artikujt e mësipërm industrialë të prodhuar prej tij, jashtë çdo kushti teknik, apo standardi të miratuar apo teknologjie të kontrolluar, si edhe të ambalazuara nëpërmjet ambalazheve të siguruara edhe nëpër kazanë të plehrave dhe të shitura nëpër trotuare apo në tregje të pakontrolluara. *Për sa i përket shtetasit ***, ai ka sqaruar se meqë nuk kishte makinë e merrte këtë person për të transportuar mallin, duke e paguar për këtë shërbim si dhe ka theksuar që *** nuk kishte dijeni se ku e merrte produktin *** pasi vinte vetëm kur ky e merrte në telefon.*

I pyetur në lidhje me faktet objekt procedimi në fazën e hetimit i pandehuri shtetasi *** ka deklaruar se është njohur me shtetasin *** në një lokal në *** në muajin maj 2016 dhe *** i ka kërkuar që t’i ndihmonte për të dërguar disa artikuj (shampo), tek fusha e zezë të tregu industrial. Për këtë arsye shkonte tek shtëpia e ***, merrte shampot në bagazh dhe bashkë me *** shkonin tek tregu, ku ai i linte artikujt (shampot) dhe largohej. Për këtë shërbim *** i jepte *** lekë të reja. Gjithashtu, ka deklaruar se, nuk ishte në dijeni se ku i gjente këto produkte shtetasi ***, pasi nuk i interesonte ky fakt dhe kishte kryer transport vetëm tre ose katër herë, por nuk ishte në dijeni se çfarë aktiviteti kryente ***.

Në fazën e hetimit janë pyetur edhe shtetasi *** (djali i shtetases ***) i cili nuk ka dhënë

informacione me rëndësi për procedimin, si edhe shtetasi *** (inspektor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë), I cili ka shpjeguar veprimtarinë e kundërligjshme të prodhimit të mallrave industriale të konstatuar prej tij në banesën e marrë me qira nga shtetasi ***.

Mbi bazën e fakteve të mësipërme, në vijim janë marrë si të pandehur shtetasi *** e *** të dyshuar për kryerjen e veprave penale të “Shkeljes së të drejtave të pronësisë industriale”, dhe të “Prodhimit të kundërligjshëm të artikujve dhe mallrave industrialë dhe ushqimorë”, të parashikuara nga nenet 149/a/2 e 288/a/2 të K.Penal.

Me Vendimin jo të formës së prerë Nr. ***, datë 06.03.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është deklaruar fajtor dhe dënuar i pandehuri *** me 2 vjet e 8 muaj burgim për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 288/a/2 i K.Penal si dhe është pushuar çështja penale ndaj tij për veprën penale të parashikuar nga neni 149/a/2 i K.Penal.

Ndërsa me Vendimin e datës 01.12.2016 të Prokurorisë së Rrethit Tiranë është disponuar pushimi i hetimeve për shtetasen *** për akuzat e atribuara, për shkak të mungesës së provueshmërisë së akuzave ndaj saj.

I pyetur nga organi procedues në fazën e hetimeve, i pandehuri nuk e ka pranuar akuzën. Po kështu edhe në seancë gjyqësore, i pandehuri u shpreh se nuk e pranon akuzën në ngarkim të tij.

Sa më sipër, u provua në gjykimin e çështjes me provat e paraqitura nga organi i akuzës dhe të administruara nga Gjykata në seancë gjyqësore, ku evidentohen:

- *Proçes-verbali i kontrollit të ambjentit dhe të automjetit datë 24.06.2016;*
- *Proçes-verbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes i shoqëruar me tabelën fotografike përkatëse datë 24.06.2016;*
- *Shkresa Nr. ***, datë 23.09.2016 e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë;*
- *Deklarimet e shtetasve ***, ***, *** etj., të dhëna në hetim;*
- *Në tërësi aktet e tjera provuese pjesë e fashikullit të hetimeve paraprake të procedimit penal Nr. *** të vitit 2016 të ndodhura në fashikullin e gjykimit.*

Mbështetur në këto fakte, ***nga përfaqësuesi i organit të akuzës u kërkua*** deklarimi fajtor i të pandehurit *** për veprat penale që i atribuohen në këtë gjykim të kryera sipas Prokurorisë në bashkëpunim me shtetasin *** dhe më shumë se një herë, si dhe dënimi i tij me burgim në masat repektive dhe atë përfundimtare të përcaktuar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Mbrojtësi i të pandehurit në konkluzionet e fundit kërkoi nga Gjykata, deklarimin e pafajshëm të të pandehurit *** për veprën penale “Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industrialë dhe ushqimorë”, parashikuar nga neni 288/a/2 i K.Penal, duke parashtruar se nuk provohet që i pandehuri të ketë kryer këtë vepër. Sipas mbrojtjes, nuk provohet që i pandehuri të ketë prodhuar këto produkte apo të ketë pasur dijeni për prodhimin e paligjshëm të tyre nga shtetasi ***. I pandehuri *** e përdorte automjetin e tij si taksi, me qëllim sigurimin e të ardhurave për familjen e tij dhe nuk kishte asnjë lidhje me aktivitetin e kundërligjshëm që ushtonte shtetasi *** dhe nuk ishte në dijeni se transportonte mallra të paligjshme.

Ndërsa për veprën penale “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, të parashikuar nga neni 149/a/2 i K.Penal, mbrojtësi i të pandehurit *** kërkoi pushimin e gjykimit për shkak të përfitimit nga amnistia të parashikuar nga Ligji Nr.141/2016.

Arsyetimi i Gjykatës, argumentat juridike, interpretimi i dispozitave referuese penale të cenuara, analiza e provave, konkluzionet e Gjykatës.

Në këto rrethana, e ndodhur përpara faktit të parashtruar më sipër, pretendimeve dhe provave të marra në gjykim, ***Gjykata çmon se veprimet e të pandehurit *** nuk plotësojnë të gjithë elementët që kërkon legjislacioni penal shqiptar për t’i cilësuar këto veprime si elementë të figurës së veprës penale të “Shkeljes së të drejtave të pronësisë industriale”, të***

*parashikuar nga neni 149/a/2 i K.Penal. Po kështu Gjykata vlerëson për arsyetimin vijues se plotësohen kërkesat ligjore për të disponuar për deklarimin e pafajshëm të të pandehurit *** për këtë veprë penale dhe jo për pushimin e çështjes në bazë të Ligjit Nr. 141/2016 datë 22.12.2016 “Për dhënie Amnistie”, në mungesë të provueshmërisë së akuzës për këtë veprë penale.*

*Gjykata çmon gjithashtu që në veprimet e të pandehurit *** nuk janë të pranishëm të gjithë elementët që kërkon legjislacioni penal shqiptar për t’i cilësuar këto veprime si elementë të figurës së veprës penale të “Prodhimit të kunderligjshëm të artikujve dhe mallrave industriale dhe ushqimore”, të parashikuar nga neni 288/a/2 i K.Penal. Nga analiza e provave dhe faktit, për Gjykatën rezulton e provuar se veprimet e të pandehurit *** plotësojnë të gjithë elementët që kërkon legjislacioni penal shqiptar për t’i cilësuar këto veprime si elementë të figurës së veprës penale të “Moskallëzimit të krimit” të parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal.*

*Në referim të arsyetimit vijues, Gjykata vlerëson se ekzistojnë kushtet ligjore të parashikuara nga neni 375 i K.Pr.Penale për të ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale për të pandehurin *** , duke i dhënë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë organi i akuzës nga neni 288/a/2 i K.Penal në nenin 300/1 të K.Penal.*

1.Vlerësimi i Gjykatës në lidhje me akuzën për kryerjen e veprës penale “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, të parashikuar nga neni 149/a/2 i K.Penal, në ngarkim të të pandehurit *.**

Në përmbajtjen e nenit 149/a/2 të K.Penal të miratuar me Ligjin Nr.7895, datë 27/01/1995, të ndryshuar, sanksionohet se:

“Prodhimi, shpërndarja, mbajtja për qëllime tregtimi, shitja, ofrimi për shitje, furnizimi, shpërndarja, eksportimi ose importimi për këto qëllime i:

b) produktit që mbrohet nga një dizeno industriale, pa pëlqimin e pronarit të dizenjës industriale;

c) mallrave ose shërbimeve që mbrohen nga një markë tregtare, pa pëlqimin e pronarit të markës tregtare; .

të kryera me dashje, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Po kjo veprë kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një here përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”.

Ndërsa në nenin 6 të Ligjit Nr.141/2016 datë 22.12.2016 “Për dhënie Amnistie” sanksionohet:

“Pushohen ndjekjet penale për çështjet në hetim, për çështjet e pashqyrtuara ose në proces shqyrtimi nga gjykatat....për veprat penale të kryera deri më datë 25/12/2016, për të cilat Kodi Penal parashikon një dënim me burgim në maksimum deri në dy vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, me përjashtim të veprave të parashikuara nga...”

Sipas nenit 71 të K.Penal përcaktohet se:

“Me Aktin e Amnistisë organi kompetent përjashton nga ndjekja penale, nga vuajtja tërësisht apo pjesërisht e dënimit ose bën zëvendësimin e dënimit me një lloj dënimi më të butë.”

Konkretisht, në analizë juridike të elementeve të figurës së kësaj vepre penale, nga

analiza e rrethanave dhe provave të çështjes, referuar deklaramëve të bashkëtepandehurit ***, deklaramëve të shtetasve *** e *** si dhe deklaramëve të vetë të pandehurit ***, për Gjykatën nuk provohet që veprimet e të pandehurit të jenë të kundërligjshëm dhe me rrezikshmëri shoqërore, për të formuar veçanërisht objektin, anën objektive dhe anën subjektive të kësaj vepre penale të parashikuar dhe kërkuar nga neni 149/a/2 i K.Penal i K.Penal, pra që këto veprime të të pandehurit të kenë cenuar ato marrëdhënie juridike të vendosura me **Ligjin Nr.9947, datë 07/07/2008 “Për pronësinë industriale”**, për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë industriale, të “markës tregtare apo dizenjës industriale” dhe të drejtave pasurore që rrjedhin nga përdorimi i tyre nga personat fizikë apo juridikë, të mbrojtura edhe me legjislacionin penal nga veprimet kriminale.

Ana objektive e kësaj vepre penale, që të konsiderohet e konsumuar, kërkon detyrimisht që këto veprime të kundërligjshme të konsistojnë në kryerjen e veprimtarisë së paligjshme të shpërndarjes së mallrave të rreme, me karakteristika të ngjashme me produktin origjinal që mbrohet nga një “markë tregtare”, pa pëlqimin e pronarit të markës, e konkretisht në shpërndarjen dhe tregtimin e produkteve shampo apo detergjentë të rreme. Nuk rezulton që nga ana e organit të akuzës të jetë hetuar dhe vertetuar me dokumentacion shkresor të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, që produkti industrial i tregtuar gëzon ruajtje dhe mbrojtje ndërkombëtare si një Markë apo Dizeno industriale regjistruar në vendin tonë dhe rrjedhimisht të gëzojë mbrojtje ligjore.

Ndërsa ana subjektive e kësaj vepre penale kërkon që këto veprime të kryhen nga subjekti shkelës me dashje direkte.

Gjykata në rastin objekt shqyrtimi çmon të theksojë se, veprimet e të pandehurit *** nuk plotësojnë njëherazi të gjitha kërkesat e elementit të anës objektive të kësaj vepre penale, pasi niveli i provave të këtij procedimi penal është i pamjaftueshëm për të vërtetuar akuzën e atribuar të pandehurit.

Konkretisht, nuk u provua në gjykim me asnjë provë dhe *tej çdo dyshimi të arsyeshëm* që i pandehuri *** të ketë kryer veprën penale të parashikuar nga neni 149/a/2 i K.Penal, e aq më tepër të provohet marrëveshja midis tij dhe shtetasit *** për të kryer këtë vepër penale si bashkëpunëtor apo qoftë dhe në prezencë të elementit cilësues më shumë se një herë. Hetimi i Organit të Prokurorisë për veprën penale të sipërcituar është jo i plotë dhe si rrjedhim kjo vepër nuk u provua në gjykim se është kryer nga i pandehuri.

Bazuar në sa më lart, bindja e brendshme e Gjykatës në lidhje me akuzën dhe dënimin e të pandehurit, formohet jo mbi bazën e dyshimeve, por mbi prova të vërteta, që përjashtojnë dyshimet. Bindja e plotë mbi fajësinë formësohet ***kur mungon çdo dyshim mbi fajësinë e të pandehurit***. Disa akte iniciuese të procedimit penal si kqyrja e vendit të ngjarjes, deklaramë personash etj, bazë e nje akuze penale të pakonfirmuar bindshëm me prova të plota që të referojnë fakte me rëndësi për zgjidhjen e çështjes dhe provueshmërinë e kësaj akuze penale ndaj subjektit shkelës të marrëdhënies juridike të mbrojtur nga legjislacioni penal, lidhjen e drejtpërdrejtë shkakësore mes veprimeve të tij dhe pasojës së ardhur, nuk mund të shërbejnë absolutisht si një bazë e mjaftueshme për të ngarkuar me përgjegjësi penale çdo person që i atribuohet një akuzë e tillë, parim i rëndësishëm e themelor ky i një procesi të rregullt ligjor.

*Po kështu Gjykata vlerëson për arsyetimin vijues se plotësohen kërkesat ligjore për të disponuar për deklarimin e pafajshëm të të pandehurit *** për këtë vepër penale dhe jo për pushimin e çështjes në bazë të Ligjit Nr.141/2016 datë 22.12.2016 “Për dhënie Amnistie”, në mungesë të provueshmerisë së akuzës për këtë vepër penale. Aplikimi i amnistisë në interpretim të kuptimit juridik e ligjor të saj kur çështja penale është në fazën e gjykimit, ka përfunduar hetimi dhe është dërguar për gjykim, kushtëzohet me vërtetimin e akuzës së atribuar subjektit shkelës të veprës penale, pra duhet detyrimisht të provohet që i pandehuri*

të ketë kryer veprën penale, por vullneti i ligjvënësit i manifestuar në Aktin ligjor të amnistisë e përjashton atë nga ndjekja penale e mëtejshme dhe dënimi për një grup veprash penale të përcaktuara e specifikuara në Ligjin referues të amnistisë.

Në vijim të këtij arsytimi, pas shqyrtimit të provave, Gjykata konkludoi se i pandehuri *, duhet të deklarohet i pafajshëm për kryerjen e veprës penale të “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, parashikuar nga neni 149/a/2 i K.Penal.**

2. Vlerësimi i Gjykatës në lidhje me akuzën për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit të kundërligjshëm të artikujve dhe mallrave industriale dhe ushqimorë”, të parashikuar nga neni 288/a/2 i K.Penal, në ngarkim të të pandehurit *.**

Në përmbajtjen e nenit 288/a/2 të K.Penal të miratuar me Ligjin Nr.7895, datë 27/01/1995, të ndryshuar, sanksionohet se:

“ Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industriale dhe ushqimorë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet”. _

Përsa i përket elementëve të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 288/a/2 i K.Penal, **objektit të veprës penale Gjykata analizon se,** në mënyrë që të cenohen marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar prodhimin e rregullt e ligjor të ***artikujve industriale***, i pandehuri *** duhej që, me veprimet aktive të tij të prodhonte dhe nxirrte në qarkullimin tregtar për shitje e përdorim produkte industriale të prodhuara në mënyrë të kundërligjshme.

Nga ana objektive, këto veprime të kundërligjshme duhet të ishin kryer nga i pandehuri *** nëpërmjet prodhimit të paligjshëm të artikujve dhe mallrave industriale e konkretisht të prodhimit të shampove dhe detergjentëve në mënyrë të kundërligjshme si dhe duke i tregtuar këto produkte në treg për përdorim për publikun. Nga administrimi i provave në gjykim rezultoi e provuar se, *një veprimtari të tillë e ushtronte në mënyrë të paligjshme dhe me qëllim fitimi* vetëm shtetasi *** (i cili rezultoi të jetë deklaruar fajtor dhe dënuar me Vendimin jo të formës së prerë Nr. ***, datë 06.03.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë), ndërsa i pandehuri ***, nuk ka marrë pjesë në prodhimin e këtyre produkteve, pasi ai ka kryer vetëm transportin tre ose katër herë të tyre. Por, duhet theksuar fakti se, për vetë rrethanat e kryerjes së kësaj veprimtarie nga shtetasi *** dhe kryerjes disa herë të transportit të këtyre mallrave nga i pandehuri ***, ky i fundit ka marrë dijeni dhe e ka mbajtur të fshehtë këtë veprimtari të kundërligjshme të kryer nga ky shtetas, duke mos e kallëzuar këtë krim në organet kompetente.

Nga analiza në tërësi e provave të administruara veprimet e të pandehurit *** nuk provohet se përbëjnë elementët e figurës së veprës penale të “Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industriale dhe ushqimorë”, të kryer në bashkëpunim e më shumë se një herë, të parashikuar nga neni 288/a/2 i K.Penal.

Për sa më lart, Gjykata çmon që veprimet e të pandehurit *** plotësojnë të gjithë elementët që kërkon legjislacioni penal shqiptar për t’i cilësuar këto veprime si elementë të figurës së veprës penale “Moskallëzimit të krimit”, parashikuar nga neni 300/1 i K.Penal të Republikës së Shqipërisë.

Në përmbajtjen e nenit 300/1 të K.Penal sanksionohet se:

“Moskallëzimi në organet e ndjekjes penale, në gjykatë, në organet e rendit publik, të pushtetit ose të administratës, i një krimi që është duke u kryer apo që është kryer, dënohet

me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet”.

Konkretisht, përsa i përket *elementëve të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 300/1 i K.Penal, objektit të veprës penale*, i pandehuri *** me mosveprimin e tij ka cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për funksionimin e rregullt të organeve të drejtësisë, luftën kundër kriminalitetit për zbulimin e vjedhjeve, dhënien e drejtësisë dhe mbrojtjen e interesave e vlerave të shoqërisë në tërësi.

Nga ana objektive, kjo vepër penale është konsumuar me mosveprimin e kundërligjshëm të pandehurit ***, i cili, i detyruar nga ligji procedural penal duhet të kallëzonte në organet kompetente të Prokurorisë apo të rendit krimin e veprimtarisë së paligjshme të prodhimit të artikujve industriale të kryer nga shtetasi ***, (përsa i përket shampove dhe detergjentëve të markave të ndryshme, për të cilat shtetasi *** nuk është i licencuar t’i prodhonte apo tregëtonte). Për këtë aktivitet i pandehuri *** kishte marrë dijeni drejtpërdrejt nga konstatimi i kësaj veprimtarie dhe përfshirja e tij në transportimin e këtyre produkteve në tregje të pakontrolluara, produkte këto të prodhuara nga ushtrimi i kësaj veprimtarie të kundërligjshme nga shtetasi ***. Për shkak të njohjes me shtetasin ***, është e kuptueshme që, i pandehuri *** e ka mbajtur të fshehtë duke mos e treguar këtë krim, deri në momentin që është zbuluar nga shërbimet e Policisë më datë 24.06.2016, kur ato kanë sekuestruar në automjetin e tij të markës “****” me targë ***, në ***, të Qytetit të Tiranës, *** copë shampo të markave të ndryshme si ***, ***, etj.

Nga hetimi e deklarimet e të pandehurit ***, ka rezultuar që, ai e kishte kryer këtë transport tre ose katër herë si shofer që kryente shpërndarjen e këtyre produkteve të palicencuara.

Nga hetimet lidhur me këtë procedim ka rezultuar e provuar se shtetasi ***, prodhonte artikuj industrialë në mënyrë të paligjshme dhe me qëllim fitimi, pa qenë i licencuar për një veprimtari të tillë nga autoritetet shtetërore dhe i pandehuri *** ishte në dijeni të prodhimit të këtyre produkteve (shampo, detergjentë), duke qenë se merrej me shpërndarjen e tyre te tregu industrial.

Nga ana subjektive kjo vepër penale është konsumuar nga i pandehuri *** me dashje direkte.

Subjekt i kryerjes së kësaj vepre penale është i pandehuri *** i cili, nga hetimi gjyqësor rezultoi të jetë i përgjegjshëm dhe ka mbushur moshën për përgjegjësi penale.

*Fajësia e të pandehurit *** në kryerjen e veprës penale të “Moskallzimit të krimit”, te parashikuar nga neni 300/1 i K.Penal, në referencë edhe të nenit 152 të K.Pr.Penale* rezultoi e provuar plotësisht nga të gjitha provat e sipërcituara të administruara nga Gjykata në seancë gjyqësore.

Për sa u analizua u provua me pretendimet e palëve në seancë dhe provat shkresore të ndodhura në dosje, pjesë përbërëse e pandarë e fashikullit gjyqësor.

*Lidhur me llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet për të pandehurin ****, Gjykata bazuar në nenet 47, 49 të K.Penal ka detyrimin ligjor të marrë në konsideratë faktin që kjo vepër penale përbën krim, që lidhet drejtpërdrejt me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, vlerëson formën e fajit në kryerjen e veprës penale (dashje direkte), qëndrimin mohues të të pandehurit për veprën e kryer, përbërjen dhe rrethanat familjare, moshën e tij, faktin që ai është i padënuar më parë si dhe rrethanat e çështjes në tërësi.

Mbështetur në sa më sipër, Gjykata konkludoi se lloji dhe masa e dënimit me burgim që duhet të caktohet ndaj të pandehurit për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 300/1 i K.Penal është ai i dënimit me burgim, sanksion i cili është ligjërisht i bazuar në dispozitën përkatëse penale, ndërsa masa e evidentuar në dispozitiv të këtij vendimi gjyqësor vlerësohet se i përgjigjet njëkohësisht rëndësisë së faktit (krim),veprës penale të kryer nga i pandehuri dhe rrethanave të mësipërme të çështjes në tërësi, që të çmuara në kompleksitet, e justifikojnë ligjërisht këtë masë dënimi dhe realizimin e qëllimit kompleks të dënimit penal lidhur me riedukimin dhe ndëshkimin e të pandehurit.

Së fundi, përsa i përket detyrimit ligjor për pagimin e shpenzimeve proceduriale hetimore e ato gjyqësore të parapaguara nga shteti, në referim të neneve 392, 393 të K.Pr.Penale, këto të fundit i ngarkohen të pandehurit ***.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 375, 379, 383, 384, 388/d, 390, 403-406, të Kodit të Procedurës Penale, si dhe neneve 1/c, 47-50, 149/a/2, 288/a/2 dhe 300/1 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë,

VENDOSI

- ***Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit ***për kryerjen e veprës penale të “Shkeljes së të drejtave të pronësisë industriale”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 149/a/2 i K.Penal.***
- ***Deklarimin fajtor të të pandehurit *** për kryerjen e veprës penale të “Moskallëzimit të krimit”, të parashikuar nga neni 300/1 i K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 2 (dy) muaj burgim.***
- ***Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale i zbritet 1/3 e dënimit duke u dënuar përfundimisht i pandehuri *** me *** burgim.***
- ***Vuajtja e dënimit me burgim për të pandehurin *** fillon nga dita e arrestimit të tij në flagrancë më datë 24.06.2016.***
- ***Shpenzimet proceduriale hetimore dhe ato gjyqësore të parapaguara nga shteti lihen në ngarkim të të pandehurit A. H.***
- ***Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së këtij vendimi.***
U shpall në Tiranë sot më datë 12.07.2017.

GJYQTAR

GJYQTAR

KRYETARE E SEANCËS

ARDIAN KALIA

ALTIN ABDIU

TEREZA LANI (MERKAJ)

SEKRETARE

ELISABETA TUSHA